

## **Deklaratë e Sekretarit të Përgjithshëm për periudhën e re të angazhimeve për Kosovën**

Grupi i kontaktit më ka informuar për marrëveshjen e arritur mbi modalitetet për negociatat e mëtejme ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Kjo përpjekje do të udhëhiqet nga Treshja e përbërë nga përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, Federatës Ruse dhe Shtetetve të Bashkuara.

Unë e përshëndes këtë iniciativë të Grupit të kontaktit. Unë shpresoj se periudha e re e angazhimeve do të shpie drejt marrëveshjes për statusin e ardhshëm të Kosovës, që mbetet prioritet i Kombeve të Bashkuara.

Bashkësia ndërkombëtare duhet të gjejë një zgjidhje me kohë, që adreson çështjet kyçe të të gjitha bashkësive që jetojnë në Kosovë dhe të sigurojë qartësi për statusin e Kosovës. Status kuoja është e paqëndrueshme.

Zyra e të Dërguarit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara për Kosovë (UNOSEK) do të lidhet në këtë proces duke qenë e gatshme që të ofrojë informata dhe qartësime sipas kërkesës.

OKB-ja do të vazhdojë të jetë konstruktive gjatë periudhës së re të angazhimit dhe do ta vazhdojë rolin e saj të rëndësishëm në Kosovë.

Grupi i kontaktit do të më raportoj deri më 10 dhjetor.

**Nju Jork, 1 gusht 2007**